

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË

Nr. 192 Rep.

Nr. 102 Kol.



KONTRATË SHITBLERJE KUOTASH

Në Tiranë, sot më datë 09/03/2018 (dymijë e tetëmbëdhjetë), përpara meje Noteres Sofika K. Braka, me zyrë në rrugën "Ismail Qemali", pallati 11/1, u paraqitën personalisht palët e poshtëshënuara për lidhjen e kësaj kontrate shitblerjeje kuotash të kapitalit të shoqërisë:

SHITËSI:

z. **Giancarmine Battigaglia**, shtetas italian, i datëlindjes 26.09.1977, lindur ne Crotone e banues ne Tirane, identifikuar me pasaporten Italiane me nr. AA28275522, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në cilësinë e ortakut të shoqërisë "**BLOKKI**" Sh.p.k., themeluar si person juridik në datën 31.01.2018, me NUIS: L 81331030 A;

BLERËSIT:


Z. Roberto POMPEI, shtetas italian, i datëlindjes 15.10.1959, e banues ne Itali, identifikuar me Letërnjoftimin e leshur nga shteti Italian me nr. AS5726152, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar; në cilësinë e ortakut të shoqërisë "**BLOKKI**" Sh.p.k., themeluar si person juridik në datën 31.01.2018, me NUIS: L 81331030 A;

z. **Marco Martinez**, shtetas italian, i datëlindjes 10/06/1992, lindur ne Cagliari, Itali e banues ne Itali, identifikuar me pasaportën Italiane me nr. YB1307231, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar,

NENI 1

Shitësit është ortak me zotërues i 1 kuote, me pjesëmarrje 45% të kuotave, shoqërisë "**BLOKKI**" Sh.p.k., regjistruar si person juridik në datën 31.01.2018, me NUIS: L 81331030 A, me seli në, Tiranë Rruga "Rreli", pallati Rreli nr. 1, kati 1, Tiranë.

1.1 Këto kuota të shoqërisë, Shitësi ia shet Blerësve te cilët pranojnë t'i blejnë ato sipas çmimit dhe kushteve të përcaktuara më poshtë në këtë kontratë.

- 
- 1.2. Nga këto kuota të kapitalit themeltar të shoqërisë "BLOKKI" Sh.p.k. që ai zotëron, Shitësi u shet Blerësve 45% të tyre, me vlerën e tyre të cilët pranojnë t'i blejnë ato, sipas kushteve dhe proporcionit të përcaktuar më poshtë në këtë kontratë.

NENI 2

- 2.1 Çmimi i shitjes së kuotave në pronësi të Shitësit, të cilat përfaqësojnë 45% të kapitalit themeltar të shoqërisë "BLOKKI" Sh.p.k., është në vlerën e tyre nominale.
- 2.2 Ky çmim është likuiduar nga Blerësit kundrejt Shitësit, dhe Shitësi deklaron se e ka marrë këtë çmim dhe nuk ka asnjë pretendim në lidhje me pagesën e tij ndaj Blerësve.

NENI 3

- 3.1 Blerësit, i blejnë kuotat që shet Shitësi, në raportin e mëposhtëm:


Roberto POMPEI, blen 35% të kuotave, kundrejt çmimit të tyre nominal prej 35.000 Lekë, dhe bëhet ortak me 90% të kuotave të kapitalit të shoqërisë "BLOKKI" Sh.p.k.

Marco Martinez, blen 10% të kuotave, kundrejt çmimit të tyre nominal prej 10.000 Lekë, dhe bëhet ortak me 10% të kuotave të kapitalit të shoqërisë "BLOKKI" Sh.p.k.

- 3.3 Me realizimin e kësaj shitblerje të 45% të kuotave të shoqërisë "BLOKKI" Sh.p.k., Blerësve u transferohen proporcionalisht të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga blerja e tyre, ndërsa Shitësi largohet nga pjesëmarrja e mëtejshme në shoqëri.

NENI 4

- 4.1 Shitësi deklaron se është pronar me të drejta të plota mbi kuotat që i transferon Blerësit; nuk ka lidhur asnjë kontratë dhe asnjë lloj marrëveshje mbi pronësinë e tyre apo që t'i ketë njohur të tretëve të drejta të çfarëdo lloji mbi to deri në datën e sotme; ai i shet këto kuota të kapitalit të shoqërisë Blerësit të lira nga çdo detyrim, barrë apo pretendim nga të tretë; të drejtat mbi to, nuk janë të përfshira në procese civile, penale, administrative,




arbitrazhi apo të çfarëdo lloj natyre tjetër që të mund të jetë shkak për
cenimin e kontratës apo titullin e pronësisë së Blerësit mbi to.

NENI 5

- 5.1 Palët deklarojnë se do të zbatojnë rigorozisht të gjitha të drejtat e detyrimet e tyre që rrjedhin nga kjo kontratë.
- 5.2 Në rast mosmarrëveshje midis tyre në zbatim të kësaj kontrate, palët do të bëjnë të gjitha përpjekjet për zgjidhjen e tyre me mirëkuptim. Në rast se nuk do të arrijnë në zgjidhje me mirëkuptim, kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë

Kontrata hartohet në 5 (pesë) kopje me nga tre fletë, me të njejtën vlerë ligjore. Une noterja, pasi iu bëra me dijëni palëve, të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga legjislacioni në fuqi për këtë kontratë shitblerjeje te kuotave që realizojnë, u lexova palëve Kontratën me zë të lartë e të qartë. Kontrata u lexua prej vetë atyre dhe, palët pasi deklarojnë se e gjejnë atë të rregullt e në përputhje me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, e nënshkruajnë në praninë time. Unë noterja e legalizoj sipas ligjit.

Z. **Giancarmine Battigaglia**, Z. **Roberto POMPEI** dhe Z. **Marco Martinez** shtetas italian, morën dijëni për përmbajtjen e kësaj Kontrate nga përkthimi i bërë në gjuhën Italiane nga z. Denis Kuçi.



PALËT KONTRAKTORE


SHITËSI

GIANCARMINE BATTIGAGLIA




BLERËSI

ROBERTO POMPEI



MARCO MARTINEZ



NOTERE
Sofika K. BRAKA

